



PRISHTINË - PRIŠTINA
Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.318/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Vedat Poterqoi – Kryetar, znj. Kimete Gashi – Referuese, z. Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Tensor I.S.S. L.L.C.”– Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE: “Cimi @ Electronic & Impact” SH.P.K.- Dega në Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vendosja dhe furnizimi me kamera të sigurisë dhe pjesë të tjera përcjellëse për institucionet edukativo arsimore dhe nevojat e tjera komunale”, me nr. të prok: 616-22-5180-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna - Prishtinë”, më datën: 26.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET, si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Tensor I.S.S. L.L.C.”– Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vendosja dhe furnizimi me kamera të sigurisë dhe pjesë të tjera përcjellëse për institucionet edukativo arsimore dhe nevojat e tjera komunale”, me nr. të prok: 616-22-5180-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna Prishtinë”.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vendosja dhe furnizimi me kamera të sigurisë dhe pjesë të tjera përcjellëse për institucionet edukativo arsimore dhe nevojat e tjera komunale”, me nr. të prok: 616-22-5180-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna - Prishtinë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Tensor I.S.S. L.L.C.”– Prishtinë, i refuzohet si e pabazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Tensor I.S.S. L.L.C.”– Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 08.08.2022 me nr. 318/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vendosja dhe furnizimi me kamera të sigurisë dhe pjesë të tjera përcjellëse për institucionet edukativo arsimore dhe nevojat e tjera komunale”, me nr. të prok: 616-22-5180-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 7 , 52 , 56 , 59 , 60 , 72 , 7 , si dhe nenit 81 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 26 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.08.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 22.08.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimor 1 – OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kërkesën për njoftimit për kontratë dhe dosjes të tenderit për katalogun, përkatësisht nuk janë vendosur linqet ashtu sikurse është kërkuar nga AK. AK, në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, tek kapaciteti teknik dhe profesional ka paraqitur kërkesën “Operatori ekonomik duhet të ofrojë katalog për kamera te sigurisë” dhe për këtë kërkesë dëshmia kërkuar dokumentare është “Katalogu të jetë i nënshkruar dhe i vulosur dhe të ketë weblink”. GOE të rekomanduar për kontratë ka dorëzuar katalogët për produktet (kamerat) e ofertuara: Hikvision DS-2CE16U1T-IT3F dhe Hikvision DS-2CE76U1T-ITPF . Në faqen e parë të katalogut tek dy produktet, është shënuar adresa e web faqes së prodhuesit, www.hikvision.com. Web faqja është aktive dhe me një kërkim të thjeshtë sipas numrit të produktit, shfaqën të dhënat për kamerat e ofertuara përfshirë edhe katalogët të cilët i ka dorëzuar GOE të rekomanduar për kontratë. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2 – Më tej OE ankues pretendon se GOE të rekomanduar për kontratë nuk plotësojnë specifikimet teknike në 3 pika për pozicionet 2 dhe 3.

a) Fillimisht, lidhur me sensorin e kamerës, AK në dosjen e tenderit, tek Aneksi 1-Specifikimet Teknike të Detyrueshme, tek pozicioni 2 dhe 3 ndër të tjera ka kërkuar: “..ImageSensor: 1/2.7" SONY; EffectivePixels: 2592(H)×1944(V), 5MP..”. GOE i rekomanduar për kontratë dorëzuar katalogët për produktet e ofertuara: për pozicionin 2 -Hikvision DS-2CE16U1T-IT3F dhe për pozicionin 3-Hikvision DS-2CE76U1T-ITPF. Sipas katalogëve produktet e ofertuara, për të dy pozicionet është ofertua me image sensor: progressive scan CMOS, 8.29 megapixel dhe rezolucion 3840 (H) × 2160 (V). AK ka kërkuar sensor apo modul të prodhuesit Sony. Përderisa në katalogun e dorëzuar nga GOE nuk ka të dhëna për prodhuesin e sensorit apo modulit. Fillimisht, krahasimi i OE ankues kur pretendon se “dallimi në kualitet të fotografisë është substancial në mes të sensorëve SONY dhe CMOS – ku ai i SONY (siç edhe është ofruar nga OE i jonë) është superior” nuk qëndron. Kjo për faktin se termi Sony i referohet prodhuesit, ndërkaq CMOS (complementary metal oxide semiconductor) nënkupton një çip elektronik i cili përdoret për të krijuar imazhe në kamera dixhitale. Edhe sensorit apo çipi i prodhuesit Sony

është CMOS sensor. Më tej, Eksperti në bazë të kërimit ka gjetur që prodhuesi Hikvision aplikon sensorë të prodhuesit Sony në disa prej kamerave. Kjo mund të vërtetohet në linjet:

- <https://us.hikvision.com/en/blog/hikvision-launches-15-new-usb-30-machine-vision-cameras-plus-4-board-level-usb-versions-limited-space-applications>
- <https://us.hikvision.com/en/blog/hikvision-launches-14-new-gige-area-scan-cameras-offering-greater-selection-rapid-data-transmission-factory-automation-and-detection>
- <https://us.hikvision.com/en/blog/hikvision-launches-new-20-mp-gige-area-scan-camera>
- <https://us.hikvision.com/en/blog/hikvision-launches-open-source-smart-cameras-intel-x86-processor-offers-integrated-camera-pc-lens-and-light-source>
- <https://us.hikvision.com/en/blog/hikvision-launches-machine-vision-products>

Në një situatë të tillë është evidente se sensorin i ofertuar nga GOE i rekomanduar për kontratë tejkalon kërkesat e pixelave dhe rezolucionit të specifikuar nga AK për sensorin e kamerës, përderisa nuk ka informacione për prodhuesin. Andaj pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

b) Më tej lidhur me pikën për Power Supply, AK në dosjen e tenderit, tek Aneksi 1-Specifikimet Teknike të Detyrueshme, tek pozicioni 2 dhe 3 ndër të tjera ka kërkuar: PowerSupply: 12V DC $\pm 1\%$ përkatësisht OperatingVoltage: DC 12 V $\pm 1\%$.

GOE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me produktet katalogët për produktet e ofertuara: për pozicionin 2 -Hikvision DS-2CE16U1T-IT3F dhe për pozicionin 3-Hikvision DS-2CE76U1T-ITPF. Tek dy produktet në broshurë përshkruhet se rangun 12 V DC $\pm 25\%$, që rrjedhimisht përmbushë kërkesën dhe shkon përtej intervalit të kërkuar, e i cili nuk është kufi maksimal i lejuar. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

c) Në fund, sa i përket pikës për konsumin e energjisë, tek pozicioni 2 në specifikimet teknike të dosjes së tenderit ndër të tjera është kërkuar “..PowerConsumption: Max 4.2W..”. Kurse produkti i ofertuar nga GOE i rekomanduar për kontratë konsumin maksimal të energjisë e ka Max. 5.3 W. Pra është përtej maksimumit apo kufirit të lejuar (maksimal) me specifikat e dosjes së tenderit. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3 –OE ankues pretendon se nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit të dhëna nga AK për OE ankues. AK në letrën standarde për OE ankues si tenderues i eliminuar në këtë procedurë të prokurimit ka listuar arsyet e eliminimit: Operatori Ekonomik

Tenzor I.S.S. Nuk i përmbush specifikimet teknike sipas katalogut të ofruar. Linqet e ofruara nuk janë në përputhje me specifikat e kërkuara në dosje të tenderit si në vijim: Pozicioni nr.1 a) nuk e përkrah Twoway audio; b) nuk e përkrah IVS dhe face detection. Pozicioni nr2. a) nuk e përkrah Operation temperature - 10+60C.

a)Sa i përket pretendimeve në lidhje me funksionet twoway audio, IVS dhe face detection, është evidente se produkti i ofertuar nuk plotëson këto karakteristika. OE ankues pretendon se ka ofertuar pa këto funksione me qëllim të respektimit të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Rregulloreve të Agjencisë për Informim dhe Privatësi. Eksperti sqaron se bazuar në të dhënat (dokumentet) e ngarkuara në eprokurim, OE ankues nuk ka kërkuar sqarime në lidhje me çështjet e sipërpërmendura gjatë fazës së sqarimeve konform nenit 53 të LPP-së. Për më tepër, OE ankues nuk ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim përkatësisht ankesë në lidhje me dokumentet e tenderit para dorëzimit të ofertës. Rrjedhimisht, duke dorëzuar ofertë, kërkesat dhe kushtet e njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit i ka marrë si të mirëqena. Andaj pretendimi ankimor nuk është i bazuar duke marrë për bazë Nenin 59 të LPP-së ku thuhet se AK do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

b) Lidhur me arsyen e eliminimit për temperaturën e operimit, në dosjen e tenderit, aneksin 1 të specifikimeve teknike, tek pozicioni 2 ndër të tjera është kërkuar “WorkingEnvironment: -40°C~+60°C”. OE ankues ka ofertuar me produktin e prodhuesit Longse, modeli BMSCHT(CTH)C500ESL. Sipas katalogut të dorëzuar për këtë produkt Operation Temperature (temperatura e operimit) është: -10°C ~ +60°C. Rrjedhimisht nuk përmbushet minimumi i vlerës së temperaturës së kërkuar në specifikimet teknike. Më tej lidhur me pretendimin se ky është një devijim minimal dhe duhet të tolerohet nga AK, Eksperti sqaron se sipas Nenit 59 të LPP-së, paragrafi 4, pika ii, thuhet se AK mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Në këtë rast devijimi nga -40 në -10, është -30 gradë, e që nuk është dallim i vogël pavarësisht pretendimit për vlerat historike të temperaturave. Për më shumë, konform sqarimit të dispozitës së mësipërm, devijimet pas

kuanifikimit mund të merren parasysh gjatë krahasimit të ofertave. Në këtë kuptim AK mund ta konsiderojë pranimin e devijimit duke aplikuar të njëjtin standard tek të gjithë OE-të në procedurë, me qëllim që ti trajtojë të gjithë barabartë dhe duke mos diskriminuar ndonjërin nga OE-të në procedurë. Andaj, sipas sqarimit të mësipërm, marrë për bazë faktin që produkti i ofruar nuk plotëson specifikat teknike për këtë pozicion, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, më tej rekomandohet që të anulohet vendimi i AK-së dhe të obligohet AK që aktivitetin e prokurimit ta kthejë në rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 22.08.2022, me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues,(Nuk ka kthyer përgjigje).

Operatori Ekonomik: “Tensor I.S.S. L.L.C.”– Prishtinë, me datë: 24.08.2022, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, pajtohet me mendimin e ekspertit.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 22.09.2022, me praninë e palëve në procedurë ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbalë mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues

deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankuse se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kërkesën për njoftimit për kontratë dhe dosjes të tenderit për katalogun, përkatësisht nuk janë vendosur linqet ashtu sikurse është kërkuar nga AK. Këtë pretendim PSH e klasifikon të pabazuar dhe e mbështet arsyeshmërin e ekspertit shqyrtues, dhe këto arsyetime llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankuse se OE i rekomanduar rekomanduar për kontratë nuk plotësojnë specifikimet teknike në 3 pika për pozicionet 2 dhe 3. a) Lidhur me sensorin e kamerës, b) Lidhur me pikën për Power Supply, c) Sa i përket pikës për konsumin e energjisë. Këtë pretendim PSH e klasifikon si pjesërisht të bazuar dhe e mbështet arsyeshmërin e ekspertit shqyrtues, dhe këto arsyetime llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues. Por PSH këto i klasifikon si devijime të vogla dhe sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-së, autoriteti kontraktues do ta konsiderojë tender si të përgjegjshëm.

Sa i përket devijimit për konsumim të energjisë elektrike, OE i rekomanduar ka ofertuar me një diferencë prej 1.1 W, në konsumim maksimal të energjisë. Kjo diferencë në kuptimin e harxhimit të energjisë elektrike është mjaftë e ulët duke marrë parasysh, se kamera jo rregullisht harxhon maksimumin e energjisë elektrike të specifikuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankuse se nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit të dhëna nga AK për OE ankues. Këtë pretendim PSH e klasifikon të pabazuar dhe e mbështet arsyeshmërin e ekspertit shqyrtues, dhe këto arsyetime llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale -Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – “KK - Prishtinë”,
- 1x1 OE - “Tensor I.S.S. L.L.C.”– Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

